



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2020:078174

Datë: 13.08.2020

Numri i dokumentit: 01062839

**DKR P nr.111/20**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TE RENDA**, sipas Kryetares se Trupit Gjykes – Gjyqtares Lumturije Muhaxheri, me pjesëmarrjen e bashkpuntorës profesionale Gylai Nepola , në çështjen penale ndaj të pandehurit A. Sh., nga fsh.....Komuna ....., i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti i Krimeve të Rënda PP/I nr.68/20 të datës 03.07.2020, për shkak të veprës penale mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së, në seancën e shqyrtimit fillestar, publik të mbajtur me dt.11.08.2020, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Agron Galani , të pandehurit A. Sh. , të njëjtën ditë murr dhe me dt.13.08.2020, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri A. (H.) SH.**, i identifikuar në bazë të letërnjoftimit me nr..... dt....., i lindur me ....., në fsh....., Komuna ....., rr..... nr.4, i biri i H. dhe nënës H., e gjinisë B., ka të kryer fakultetin gjuhë dhe letërsi shqipe, me profesion mësimdhënës tani i pensionuar, i martuar baba i tre fëmijëve, Shqiptar Shtetas i Republikës së Kosovës, gjendet në liri,

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Më parë e gjerë me dt.02.03.2019, rreth orës 13:30 minuta, në shtëpinë e tij në fsh....., Komuna e ....., në mënyrë të paautorizuar dhe në kundërshtim me nenin 5 par.1 të Ligjit për Armë ( Ligji Nr.05/L-022), ka mbajtur në pronësi dhe kontroll një pushkë automatike ....., cal.7.62x39 mm., me numër serik 14172797, së bashku me dy karikator të zbrazët dhe 15 fishek t cal.7.62x39 mm, e cila armë dhe municion janë sekuestruar dhe konfiskuar, pas bastisjes së shtëpisë së të pandehurit të kryer edhe me pëlqimin e pandehurit,

-me çka ka kryer veprë penale mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Gjykata me aplikimin e dispozitave ligjore nga neni 4, 7, 17 par.1, 21 par.2, 38, 43, 69, nenit 366 par.1 dhe 3 të KPK-së, nenit 365, 366, të KPPRK-së, të pandehurin , e

## **G J Y K O N**

Me **DËNIM ME GJOBË** në shumë prej 500 € (pesqindë ) euro, të cilën shumë është i detyruar ta paguajë në afat prej 90 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast të mos pagimit të dënimit me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje, prej (25 ) ditësh, ashtu që çdo 20 € (njëzet) euro, të dënimit me gjobë, i përcakton një ditë burg.

Të pandehurit i konfiskohet një pushkë automatike ....., cal.7.62x39 mm., me numër serik 14172797, së bashku me dy karikator të zbrazët dhe 15 fishek të cal.7.62x39 mm, dhe urdhërohet shkatërrimi i saj, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, numri rastit në polici 2019-DC-67 të dt. 12.03.2020.

I pandehuri obligohet që në emër të paushallit gjyqësorë gjykatës ti paguaj shumën prej 20 (njëzetë) € euro, të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore ne Peje - Departamenti për Krime te Renda ne Pejë, ka ngrit aktakuzë, PP/I nr.68/20 të datës 03.07.2020 , ndaj të pandehurit A. Sh., nga fsh.....Komuna ....., për veprë penale mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, Gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 246 par.4 të KPPK-se, të pandehurit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë. Me këtë rast, Gjykata, edhe një herë e ka udhëzuar të pandehurin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 248 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPRK-se, kështu që i pandehuri ka deklaruar së është plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë e pranimit të fajësisë dhe shton së ky deklarim paraqet shprehje të vullnetit të tij të lirë, pasi që ai është kryes i kësaj veprë penale të cilën nuk ka si ta mohoj, e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar , dhe se pranimi i fajësisë nga ana e tij është i mbështetur edhe në provat të cilat i janë ofruar gjykatës me aktakuzë, të njëjti i vie keq dhe shpreh pendim për rastin.

Pas deklarimit të pandehurit për pranimin e fajësisë, Kryetarja e trupit gjykues, kërkoi mendimin e vet për këtë ta japi prokurori i shtetit.

Prokurori i Shtetit-Agron Galani, në këtë drejtim deklaroi, se pajtohet në tërësi me pranimin e fajësisë nga ana e pandehurit, nga se ky pranim i fajësisë është i mbështetur edhe në prova materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës, pranimi i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetare, pasi që është njoftuar me të drejtat dhe obligimet që rrjedhin nga pranimi i fajësisë, për çka i propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, si dhe të bëhet konfiskimi i armës dhe municionit të sekuestruar.

Në vijim, Gjykata duke e shqyrtuar pranimin e fajësisë, nga ana e të pandehurit, vlerësoi së pranimi i fajësisë paraqet shprehje të vullnetit të lirë të pandehurit, pasi që ai e ka kuptuar

natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë dhe pranimi i fajit është bërë në mbështetje të fakteve të prezantuara në aktakuzë, në përputhje me kërkesat e nenit 248 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPRK-së, bazuar në të lartcekurat gjykata pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri, për shkak të veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga gjendja e vërtetuar faktike, siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit A. Sh., qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par.1 të KPRK-së.

Sa i përket fajësisë, Gjykata ka gjetur se të pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke pas parasysh se Gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit në shqyrtimin fillestar, ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 248 par. 4 të KPPRK-së, dhe bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Prishtinë dhe, Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të EULEX-it, me nr.GjA.nr.207/13 dt.19.03.2013, në këtë çështje penale nuk është mbajtur seanca e dytë e as ajo e shqyrtimi gjyqësor, një herë edhe me rastin e shpalljes së të pandehurit fajtor dhe shqiptimin e dënimit nuk është plotësuar fare trupi gjykues.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 par.1 të KPRK-se. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, Gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti kishte sjellje korrekte gjatë procedurës penale, i njëjti më parë nuk ka ra në konflikt me ligjin, është penduar për veprën penale, duke i premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris veprimet e tilla, moshën e tij të shtyer është pensioner, , i martuar, të gjitha këto Gjykata i ka pranuar si rrethana favorizuese, Si rrethanë tjetër posaçërisht lehtësuese gjykata e merr faktin se i pandehuri në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën pandehet, gjë që dëshmoi gatishmëri për bashkëpunim me organin e akuzës dhe me gjykatën, dhe kjo sipas vlerësimit të gjykatës paraqet pendim të sinqertë të tij dhe fillim të procesit të rehabilitimit të tij. Andaj në prezencën e këtyre rrethanave lehtësuese, e në mungesë të ndonjë rrethane rënduese, të pandehurin e gjykoj me dënimin me gjobë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me të cilën do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Duke i vlerësuar kështu të gjitha rrethanat e parashikuar me nenin 69 par.1 të KPRK-se, Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen por ai do të

ndikoj edhe si preventive gjenerale për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 38 të KPRK-se .

Vendimi për konfiskimin dhe asgjësimin e armës , të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, është marr në kuptim të nenit 366 par.3 të KPRK-se.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor është i bazuar në lartësinë reale të shpenzimeve të shkaktuara për zhvillimin e këtij procesi penal, prandaj gjykata duke u bazuar në nenin 450 të KPPRK-se të pandehurin e obligoi në pagimin e shpenzimeve të paushallit gjyqësor.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në nenin 368 par.2 të KPPK-se, Gjykata palët në procedurë i njoftoi me paralajmërimet që shoqërojnë aktgjykimin.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RENDA,  
DKR P.nr.111/20 dt.11.08.2020, i përpiluar me dt.13.08.2020.**

**Bashkëpuntorja profesionale :  
Gylai Nepola**

**Kryetarja e Trupit Gjyqësor  
Lumturije Muhaxheri**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimit. Ankesa i dërgohet Gjykatës